



BASHKIA E TIRANES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE
TERRITORIT
DREJTORIA E PROJEKTIMIT

RELACION TEKNIK

RRETHIMI I PRONËS "ISH REPARTI USHTARAK
NR. 501 1/45- SURREL"

INVESTITOR: BASHKIA TIRANE

PROJEKTOI : DREJTORIA E PROJEKTIMIT

Veshtrim i pergjithshem

Ish Reparti Ushtarak nr 501, 1/45 Surrel perdoret nga Shoqata e Invalideve Para-Tetraplegjike te Shqiperise –SHIPT sipas kontrates se Huaperdorjes nr.4389/1 prot, date 16.02.2021 nepermjet Bashkise Tirane dhe SHIPT per nje afat 10 vjecar .

Por kjo prone ka nevojte te rrethohet ne lidhje me pronat e tjera qe e kufizojne ate, ne menyre te tille qe Shoqata e Invalideve Para-Tetraplegjike te Shqiperise –SHIPT te ushtroje veprimtarine e saj ne ambjentet e percaktuara ne menyre rigoroze te qete dhe te sigurt per secilin anetar te saj.Per kete arsye ne Programin Buxhetor Afatmesem 2022-2024 eshte vendusur dhe realizimi I rrethimit te Ish Repartit Ushtarak nr.501. 1/45 Surrel sipas Vendimit nr.176, date 21.12.2020 te Keshillit Bashkiak Tirane.

Nëpërmjet këtij projekti, Bashkia e Tiranës synon të rehabilitojë dhe të konturojë pronën e mesipërme dhe të zgjidhë këtë problematikë që ka hasur Shoqata e Invalideve Para-Tetraplegjike të Shqipërisë –SHIPT.

Në total sipërfaqja është afërsisht 3300 m² .

Specifikisht në këtë projekt është parashikuar të realizohet rrethimi i Ish repartit Ushtarak nr.501, 1/45 Surrel.


-GJENDJA AKTUALE.

Ish Reparti Ushtarak nr.501 1/45-Surrel pasi u realizua kalimi i pronës, lind nevoja për rrethimin e kësaj prone, në mënyrë të tillë që të konturohet nga zona përreth saj.



-INVESTIMI I PARASHIKUAR


Investimi i parashikuar eshte i tille qe te mbuloj realizimin punimeve te ndertimit per rrethimit e Ish Repartarit Ushtarak nr.501 1/45-Surrel.



Pergjate gjithe perimetrit te prones do te behet rrethimi me nje mur rrethues me themel betoni dhe me kangjella metalike. Ai do te kete gjatesi rreth 235~240 ml dhe ne hyrje te prones do te vendosetnje dere metalike me hapje me reshqitje. Ky rrethim do te realizohetme nje themel te zhkallezuar betonarme duke vazhduar me nje mure tulle me lartesim 1 m dhe sipër tij do kete element vertical kangjella metalike.

Rrethimi ne total ka nje lartesi rreth 2 m.

Terreni ne zone vjen me disnivel dhe do punohet sipas tij duke u pershtatur qe rrethimi te jete I rregullt dhe uniform.



Kangjellat duhet të jenë të bëra prej metali dhe të saldohen/ngjiten mirë me kolonat. Ata duhet të lyhen të paktën dy herë me bojë kundër korrosionit. Format dhe pamja e kangjellave do të vendoset së bashku me arkitektin/inxhinierin dhe klientin. Duhet të vendosen dy dyer ose porta të jashtme metalike. Njëra duhet të plotësojë kërkesat e kalimit të makinave, kurse tjetra duhet të plotësojë kërkesat e kalimit të njerëzve.

Cilesia e materjaleve

Te gjitha materjalet e perdorura duhet te jene te shoqeruara me cerfikatën e cilesise nga fabrika.

Hartoi
Ing.Sonila Isufi

Kontrolloi
Ing.Fatmir Hoxha
PERGJ. I SEK.PROJEKTIMIT INXHINIERIK